**PROCESVERBAL DHE VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE SHOQERISE AKSIONARE "SALUS TIRANA" SH.A.**

Sot, me 30/11/2010, ne oren 09.00, prane selise se Studios "Tonucci & Partners Albania" Sh.p.k. ne Rr. "Abdi Toptani", Torre Drin, K/2, Tirane, Shqiperi, ne prani te:

1. Z. Olti Peçini, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, me 19.08.1977, me banim ne Tirane, me Leternjoftim Shqiptar n. 029779562, ne cilesine e ortakut te Shoqerise Salus Tirana Sh.A. (ne vijim "**Shoqeria**"), zoterues i 50,00% (pesedhjetë,00 perqind) te kapitalit te Shoqerise dhe ne cilesine e Administratorit te Shoqerise;

2. Shoqeria Policlinico Triestino S.p.A, shoqeri e se drejtes italiane, zoteruese e 29,59% (njezet e nente,59 perqind) te kapitalit te Shoqerise, perfaqesuar ne kete mbledhje nga z. Franco Stock, qytetar italian, lindur me 24.06.1963 ne Trieste, Itali, me banim po aty ne Via Cattedrale n. 5, me karte identiteti italiane n. 2115088AA;

3. Shoqeria Finest S.p.A, shoqeri e se drejtes italiane, zoteruese e 20,41% (njezet,41 perqind) te kapitalit te Shoqerise, e perfaqesuar ne kete mbledhje nga z. Franco Stock, qytetar italian, lindur me 24.06.1963 ne Trieste, Itali, me banim po aty ne Via Cattedrale n. 5, me karte identiteti italiane n. 2115088AA;

4. Z. Davide Gregori, qytetar italian, lindur me 15.10.1968 ne Trieste, Itali me banim po aty ne via Rossetti 59, me pasaporte italiane nr. Y 181041 me cilesine e Administratorit te Shoqerise.

Eshte gjithashtu e pranishme ne cilesine e te ftuares Av. Enkelejda Muçaj.

Eshte gjithashtu e pranishme ne cilesine e te ftuares dhe te perkthyeses znj. Kozeta Speci

****

Merr persiper drejtimin e Asamblese Z. Franco Stock, i cili pasi konstaton prezencen e ortakut qe perfaqeson 50,00% te kapitalit te Shoqerise, dhe te ortakut qe perfaqeson 29,59% te kapitalit te Shoqerise, dhe te ortakut qe perfaqeson 20,41% te kapitalit te Shoqerise, e deklaron asamblene si te mbledhur sipas rregullave dhe te afte te marre vendime mbi rendin e dites, dhe pasi ka thirrur Z. Davide Gregori – i cili pranon – te beje Sekretarin,

**e deklaron**

Asamblene te mbledhur rregullisht dhe te afte per te vendosur mbi rendin e dites sic vijon:

**SEKSIONI I**

1. Njoftim i dhenies si kontribut nga Policlinico Triestino S.p.A. te nje pjese te aksioneve qe ai zotëron tek Salus Tirana Sh.A. tek shoqeria Salus Holding S.p.A. dhe ndryshimi i nenit 5.1 te statutit te shoqerise Salus Tirana Sh.A.

2. Emerimi i ekspertit kontabel te regjistruar te shoqerise.

3. Rritja e kapitalit themeltar te Shoqerise.
   a. Modalitetet e rritjes se kapitalit te shoqerise.
   b. Emerimi i Ekspertit Kontabel per te verifikuar shumat te cilat i jane dhene shoqerise ne formen e financimit te ortakeve dhe qe do te perdoren per rritjen e kapitalit te Shoqerise.
   c. Autorizimi i mundshem per kryerjen e formaliteteve te publikimit.

Me pas, fillon te trajtohet pika e pare e rendit te dites.

1. **Njoftim i dhenies si kontribut nga Policlinico Triestino S.pA. tek Salus Holding S.p.A. te nje pjese te aksioneve te Salus Tirana Sh.A. dhe ndryshimi i nenit 5.1 te statutit te shoqerise Salus Tirana Sh.A.**

Ne lidhje me piken e pare te rendit te dites Kryetari informon asamblene se ortaku Policlinico Triestino S.p.A. ka dhene si kontribut ne natyre ne kapitalin themeltar te shoqerise se tij te kontrolluar Salus Holding S.p.A. ne te cilen eshte ortak i vetem, nje numer prej 450.000 (katerqind e pesedhjetemije) aksionesh, te cilat i korrespondojne nje pjesemarrjeje prej 9,18 % (nente,18 per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise Salus tiranna Sh.a. per nje vlere ne para prej 450.000 (katerqind e pesedhjetemije) Euro.

Ne kete kuader, Kryetari informon asamblene se ne baze te nenint 7.6 te Statutit te Shoqerise ky trasferim eshte i perjashtuar nga ushtrimi i se drejtes se parablerjes nga ana e ortakeve te tjere te Shoqerise, per arsye se kemi te bejme me nje trasferim aksionesh nga nje aksioner i shoqerise ne nje shoqeri te kontrolluar prej tij.

Ne vijim te ketij lloji operacioni shoqeria Salus Holding S.p.A. behet titullare e nje numri prej 450.000 (katerqind e pesedhjetemije) aksionesh, te cilat i korrespondojne nje pjesemarrjeje prej 9,18 % (nente,18 per qind) te kapitalit themeltar te Shoqerise Salus Tirana Sh.a. per nje vlere ne para prej 450.000 (katerqind e pesedhjetemije) Euro.

Ne vijim te ketij operacioni pjesemarrja e shoqerise Policlinico Triestino S.p.A. ne kapitalin themeltar te shoqerise Salus Tirana Sh.a. do te reduktohet per nje vlere te barabarte me aksionet e trasferuara tek shoqeria Salus Holding S.p.A..

Merr fjalen ortaku Peçini i cili deklaron se e gjen operacionin ne perputhje me dispozitat e statutit, dhe se nuk ka kundershtime ne lidhje me te.

Merr fjalen Kryetari ne cilesine e perfaqesuesit te ortakut Finest S.p.A. i cili deklaron se e gjen operacionin ne perputhje me dispozitat e statutit, dhe se nuk ka kundershtime ne lidhje me te.

Av. Muçaj informon asamblene se ne driten e ketij operacioni eshte e nevojshme qe Asambleja e ortakeve te modifikoje nenin 5.1 te statutit te shoqerise.

Av. Muçaj informon gjitthashtu se shoqeria Salus Holding S.p.A. do te mund te ushtroje te drejtat e saj perkundrejt te treteve dhe shoqerise, ne vijim te regjistrimit te veprimit prane regjistrit te aksioneve te Shoqerise nga ana e administratoreve te saj.

Pas nje diskutimi te gjere Kryetari fton ortaket te shprehen me votim ne lidhje me sa me siper, dhe konstaton voten pro te ortakut Policlinico Triestino S.p.A. dhe voten pro te ortakut Peçini, dhe voten pro te ortakut Finest S.p.A.. Ne keto kushte, Asambleja me shumice absolute:

**vendosi**

i) Te miratoje perberjen e re te aksionareve se shoqerise dhe ndryshimin e nenit 5.1 të Statutit të Shoqërisë sipas tekstit në vijim

*"Neni 5.1*

*5.1 Kapitali i Shoqerise teresisht i nenshkruar dhe i paguar eshte Euro* ***4.900.000*** *(katermilion e nenteqind mije Euro) i barazvlefshem me 662.916.000 Leke (gjashteqind e gjashtedhjete e dy milion e nenteqind e gjashtembedhjete mije Leke) i cili perbehet nga* ***4.900.000*** *(katermilion e nenteqind mije) aksione te zakonshme me nje vlere nominale prej 1 (Nje) Euro secili. Kapitali eshte nenshkruar dhe paguar si me poshte:*

- *Shoqeria Policlinico Triestino S.p.A, 1.000.000 (nje milion) aksione, te cilat perbejne 20,41% (njezet,41 per qind) te kapitalit te Shoqerise per nje vlere ne para prej 1.000.000 (nje milion) Euro;*

- *Shoqeria Salus Holding S.p.A, zoteron 450.000 (katerqind e pesedhjetmije) aksione te cilat perbejne 9.18 % (nente,18 per qind) te kapitalit te Shoqerise, per nje vlere ne para prej Euro 450.000 (katerqind e pesedhjetmije);*

- *Z. Olti Peçini zoteron 2.450.000 (dymilion e katerqindepesedhjetmije) aksione te cilat perbejne 50.00% (pesedhjete per qind) te kapitalit te Shoqerise, per nje vlere ne para prej 2.450.000 (dymilion e katerqind e pesedhjete mije) Euro;*

- *Shoqeria Finest S.p.A, zoteron 1.000.000 (nje milion) aksione, te cilat perbejne 20,41% (njezet,41 per qind) te kapitalit te Shoqerise per nje vlere ne para prej 1.000.000 (nje milion) Euro.*

ii) Te kerkoje dhe autorizoje administratoret e shoqerise qe te kryejne regjistrimin e veprimit prane regjistrit te aksioneve dhe prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe çfarëdo autoriteti tjetër kompetent.

* * *

**2. Emerimi i ekspertit kontabel te regjistruar te shoqerise.**

Ne lidhje me piken e dyte te rendit te dites Kryetari informon Asamblene qe ne baze te neneve 10.2 germa b) dhe c) dhe 15 te statutit te shoqerise eshte e nevojshme qe te procedohet me emerimin e ekspertit kontabel te shoqerise per vitin ushtrimor 2010 dhe fton ortaket te shprehen me votim ne lidhje me emerimin dhe kompensimin e Ekspertit Kontabel te Regjistruar te Shoqerise.

Pas nje diskutimi te gjere Kryetari fton ortaket te shprehen me votim ne lidhje me sa me siper, dhe konstaton voten pro te ortakut Policlinico Triestino S.p.A. dhe voten pro te ortakut Peçini, dhe voten pro te ortakut Finest S.p.A., prandaj Asambleja me shumice absolute:

***emeron***

- Znj. Valbona Musa Merko, qytetare shqiptare, lindur ne Skrapar, me 05.01.1972, me vendbanim ne Tirane ne Rr. Reshit Çollaku, Pallati Shallvare, Ekspert Kontabel i regjistruar me nr. regjistri 137, datë 28.01.2005; dhe
- Znj. Vera Fazlli Lala, qytetare shqiptare, lindur ne Tirane, me 08.03.1968, me vendbanim ne Tirane ne Rr. Fadil Rada, Pallati Rruga Ura, Shk. 1, Ap. 2, Ekspert Kontabel i regjistruar me nr. regjistri 135, datë 27.01.2005.

te cilet kane pranuar dhe deklaruar paraprakisht se ne ngarkim te tij nuk ekziston asnje pengese ligjore per te mos t'u zgjedhur.

Ekspertet Kontabel te Regjistruar i Shoqerise do te qendrojne ne detyre per nje periudhe prej 1 (nje) viti, deri ne miratimin e bilancit te vitit ushtrimor 2010.

Asambleja me mazhorance absolute vendos kompensimin e Eksperteve Kontabel te regjistruar ne vleren €. 1.500 (njemije e peseqind Euro) në vit.

***

**3. Rritja e kapitalit themeltar te Shoqerise.**

   **a. Modalitetet e rritjes se kapitalit themeltar.**

   **b. Emerimi i Ekspertit Kontabel per te verifikuar shumat te cilat i jane dhene shoqerise ne formen e financimit te ortakeve dhe qe do te perdoren per rritjen e kapitalit te Shoqerise.**

   **c. Autorizimi i mundshem per kryerjen e formaliteteve te publikimit.**

Ne lidhje me piken e trete te rendit te dites Kryetari informon aksionaret se per te ecur perpara me investimin per ndertimin e spitalit sipas Biznes Planit rezulton e nevojshme te miratohet ne Asamble nje rritje e kapitalit te Shoqerise, nepermjet emetimit te aksioneve te reja. Av. Muçaj informon Asamblene se ne rast se aksionaret kane per qellim qe te perdorin financimet e tyre per rritjen e kapitalit te Shoqerise eshte e nevojshme qe procedohet me emerimin e nje Eksperti Kontabel te Regjistruar per verifikimin e shumave te cilat paraqesin financimet e aksionareve ndaj Shoqerise si dhe qe do te perdoren per rritjen e kapitalit te Shoqerise.

Administratori Peçini propozon qe kjo detyre te permbushet nga Znj. Vera Fazlli Lala Ekspert Kontabel i Regjistruar i cili do te mbeshtetet në këtë detyrë nga profesioniste te tjere te cilet gezojne besimin e tij.

Kryetari fton ortaket qe te shprehen me vote ne lidhje me miratimin e rritjes se kapitalit te permendur me siper dhe per emerimin e Ekspertit Kontabel si personi i ngarkuar per verifikimin e shumave te derdhura si financime te ortakeve perkundrejt Shoqerise. Kryetari konstaton voten pro te ortakut Policlinico Triestino S.p.A. voten pro te ortakut Peçini, dhe voten te ortakut Finest S.p.A. Ne keto kushte Asambleja me shumice absolute

**Vendosi**

1. te rrise kapitalin e Shoqerise nepermjet emetimit te aksioneve te reja per nje vlere e cila do te percaktohet ne seksionin e ardhshem te Asamblese te ortakeve.

2. Znj. Vera Fazlli Lala, qytetare shqiptare, lindur ne Tirane, me 08.03.1968, me vendbanim ne Tirane ne Rr. Fadil Rada, Pallati Rruga Ura, Shk. 1, Ap. 2, Ekspert Kontabel i regjistruar me nr. regjistri 135, datë 27.01.2005, si Ekspert Kontabel te Regjistruar per te verifikuar huate (financimet) qe ortaket i kane dhene Shoqerise.

3. te ngarkoje Administratoret z. Olti Pecini dhe Davide Gregori te veprojne veçmas per te ndjekur procedurat ligjore per realizimin e rritjes se kapitalit te Shoqerise për të kryer të gjithë veprimet e nevojshme për regjistrimin e këtij procesverbali dhe vendimi prane Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe çfarëdo autoriteti tjetër kompetent.

* * * *

Duke mos patur asgje tjeter per te vendosur, Presidenti e deklaron te shperndajë këtë seksion te Asamblese ne oren 10.30, per tu rimbledhur ne oren 12.00. Ky proçesverbal dhe vendim eshte i redaktuar ne 6 (gjashtë) kopje origjinale, ne gjuhen italiane dhe shqipe.

Firmat:

Kryetari

Z. Franco Stock

Sekretari

Z. Davide Gregori

Ortaket

Per Policlinico Triestino S.p.A

Z. Olti Peçini

Per Finest S.p.A

PERKTHYESI